



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË:	31 mars 2016 2016
REFERENCE:	
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës z. Lutfi Haziri, Komitetin e Arsimit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	DREJTORIA E ARSIMIT
NGA/OD/FROM:	NAZMI MUSA
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raporti tremujor i punës se DKA-se: janar,shkurt,mars,2016

I NDERUAR Z.KRYETAR,

Te nderuar anëtarë te Komitetit te Arsimit

Drejtoria Komunale e Arsimit, në janar te vitit 2016 filloi punën me **analizën e suksesit** të nxënësve për gjysmë vjetorin e pare te vitit shkollor 2015/2016 dhe fillimin e gjysme vjetorit te dyte. Raporti i suksesit, i cili me korrektësi e besnikëri u hartua nga zyrtaret e arsimit sipas niveleve, i njëjti u diskutua në Komitetin e Arsimit. Suksesi i 18160 nxënësve rezultoi me notë mesatare 3.70 nxënësve ,qe krahasuar me vitin paraprak, shënon një ngritje pak sa me te larte për 0,49%.

Vizitat e realizuara të zyrtareve të DKA-së në IEA për të përcjellë **zhvillimin e procesit edukativo- arsimor** : punën e mësimdhënësve, disiplinën e nxënësve, funksionimi i organeve të shkollës, bashkëpunimi me prindër kontrolli i dokumenteve pedagogjike, mirëmbajtjen e objekteve shkollore kanë ndikuar dhe ndikojnë në ngritjen e suksesit dhe cilësisë në arsim , që është njëri prej objektivit kryesor dhe synimi ynë.

2. Zhvillimi i procesit edukativo-arsimor	2.1. Realizimi i vizitave në të gjitha institucionet edukative arsimore 2.2. Vizitat e realizuara janë të ndërlidhura me zhvillimin e procesit edukativo arsimor (vijueshmëria në punë e mësimdhënësve, vijueshmëria e nxënësve, procesi i notimit të nxënësve, mirëmbajtja e objekteve shkollore, disiplina etj.). 2.3. Kontrollimi i dokumenteve pedagogjike/shkollore, monitorimi dhe respektimit të UA dhe rregulloreve, 2.4. Hartimi dhe zbatimi i formularit standard për masat disiplinore 2.5. Takime individuale me nxënësit, mësimdhënësit, dhe prindërit rreth problematikës së fëmijëve gjatë vijueshmërisë së tyre në shkollë. 2.6. Monitorimi i procesit të riatdhesimit të nxënësve në koordinim me MASHT dhe MPB. 2.7. Monitorimi i procedurave për nxënësit e migruar gjatë vitit 2014/15 dhe nxënësve të cilët janë rikthyer. 2.8. Vlerësim i FMNV nga ekipi për vlerësim 2.9. Takime me prindërit me FMNV
--	--

	2.10. Identifikimi i nxënësve analfabet 2.11. Takime me psikologet e shkollave të mesme 2.12. Takime me kujdestarët e klasave
--	---

Trajnimi i mësimdhënësve në ngritjen e profesionalizmit të tyre për metodologjitë me bashkëkohore të mësimdhënies si : Vlerësimi formativ e sumativ, vlerësimi kritik për lexim dhe shkrim, mësimdhënja dhe të nxënësve në shkencat natyrore për klasat fillore 1-5, trajnimi i mësimdhënësve të shkollave pilot në zbatimin e fushave kurrikulare dhe një varg trajnimesh të tjera, janë rezultate të ngritjes së cilësisë në arsimin gjilanas dhe fitoret e njëpasnjëshme të nxënësve në garat komunale, regjionale e ndërkombëtare në lëndën e Matematikës, Gjuhës angleze, Kimisë ,Muzikës e në Sportin shkollor. Këto trajnime janë kryer falë programit dhe bashkëpunimit të mirë me MASHT,GIZ-in Projektin e Binjakëzimit (Finlanda-Austria) ,Institutit Pedagogjik të Kosovës etj.

3. Trajnimi i mësimdhënësve Zhvillimi Profesional	3.1. Realizimi i trajnimeve për mësimdhënës: 3.1.1.Vlerësimi formativ dhe sumativ 3.1.2. Mendimi Kritik për lexim dhe shkrim 3.1.3. Mësimdhënja dhe të nxënësve në shkencat natyrore, kl.I-V 3.1.4. Trajnimi për edukatorët, niveli parashkollor 3.1.5. Trajnimi i shkollave pilot për fushat kurrikulare 3.1.6. Trajnimi, dëmtimi në të pamur 3.1.7. Komuniteti të mësuarit së bashku 3.1.8. Trajnimi i mësimdhënësve për TIK 3.1.9. Trajnimi i koordinatorëve të cilësisë për shkollat pilot 3.1.10. Trajnimi për sistemimin e nxënësve të riatdhesuar 3.1.11. Trajnimi për trajner: Ekstremizmi i dhunshëm fetar 3.1.12. Trajnimi për përvojat nga ekipet vlerësuese të komunave 3.2. Pjesëmarrja në Konferenca – Punëtori, si: 3.2.1. Arsimi cilësor për të gjithë 3.2.2. Multikulturalizmi ndëretnik në shtetet ballkanike 3.2.3. Vlerësimi i performancës së shkollës (vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm) 3.2.4. Punëtori për draft ligjin e inspektoratit të arsimit 3.2.5. Punëtori për përpilimin e doracakut për aktivitetet profesionale 3.2.6. Punëtorë planifikuesë “Zhvillimi i kapaciteteve në arsimin para universitar” 3.2.7. Punëtori - “Strategjia kombëtare e arsimit 2017/21” 3.2.8. Punëtori regjionale me ekipet vlerësuese komunale ”Prezantimi i strategjisë për arsimin gjithëpërfshirës”
--	---

Drejtoria komunale e Arsimit ka kërkuar e vlerësuar **Planet Zhvillimore të Shkollave, Planin vjetor të punës se DKA-së**, si dhe **Planin e veprimit për përmirësimin e shërbimeve ne nivelin e edukimit parashkollor**: përmbajtjen dhe realizimin e objektivave të shkollave, planifikimin e mësimin praktik të nxënësve, planifikimin e shënimeve të festave shtetërore, siguria dhe shëndeti i nxënësve si dhe ekspozita e nxënësve të shkollës së artit pamor për festën e 7 Marsit-Ditën e Mësuesit, pa i lënë në harresë kontributin e veteranëve të arsimit, të cilëve Zyra e Kryetarit u ndau Mirënjohje postmortum

4. Aktivitetet e ndërlidhura me shkollat	4.1. Kontrollimi dhe vlerësimi i PZSH të shkollave(shpërblimi i 23 shkollave). 4.2. Kontrollimi shëndetësor për nxënësit e klasave të I – V –IX në bashkëpunim me QKMF 4.3. Monitorimi i praktikës profesionale për shkollat profesionale, në bashkëpunim me inspektorët e arsimit (SIA) 4.4. Grumbullimi i shënimeve për mësimdhënësit që kanë punuar në periudhën 1990-1999 4.5. Përgatitja për shënimin e Festës së Abetares e cila do të mbahet në këtë vit në Komunën e Gjilanit 4.6. Pjesëmarrje në organizimin për nderë ditës së Shkollës 4.7.Organizimi i debateve dhe tryezave me nxënës: Siguria në shkolla - Dukuritë negative - Parandalimi i braktisjes nga shkolla. 4.8. Përgatitja e Manifestimit të 7 Marsit ”Dita e Mësuesit” dhe realizimi i ekspozitës nga shkolla e artit pamor. 4.9. Ndarja e mirënjohjeve për mësimdhënësit e arsimit ‘postmortum’ nga Zyra e Kryetarit.	Pjesëma rrja e nxënëse
5. Përgatitja e Planit dhe Raporteve të DKA	5.1. Përgatitja e Planit vjetor të DKA-s për vitin 2016 5.1.1. Përgatitja e raportit tre mujor të DKA-së 5.2. Punëtori për përgatitjen e Planit të Veprimit për përmirësim të shërbimeve në nivelin e edukimit parashkollor	

ve **në garat komunale, republikane e ndërkombëtare** në lëndët e fushat e ndryshme të kulturës ,artit e shkencës nga dita në ditë, nga viti në vit, duke i zënë vendet e para, të dyta e të treta, po ia shtojnë krenarinë Gjilanit dhe motivimin nxënësve për të arritur dituri e cilësi në procesin mësimor.

6.Organizimi dhe realizimi i garave të njohurive dhe shkathtësive	6.1. Organizimi dhe realizimi i garave në nivel komunal: 6.1.1.Eshte mbajtur Olimpiada e Matematikanëve- gara në nivel shkolle dhe Komune për nxënësit e klasave 9.10.11.12. Ndërsa për klasat 6.7.8 janë në realizim. 6.1.2. Realizimi i garave komunale për SHML në lëndët: gj. shqipe, angleze, fizikë, kimi, biologji që do të mbahen më 16.04.2016 6.2. Pjesëmarrja e nxënësve tanë në garat regjionale, organizuar nga Kolegji ”Mehmet Akif“ në lëndët: kimi dhe gj. angleze 6.3.Pjesëmarrja e nxënësve tanë ne garën e organizuar nga Kolegji” Hasan Nahi” EUREKA” 6.4.Në organizimin me temën “KMUNA-Debat Republikan “ kanë marrë pjesë nxënësit e Gjimnazeve. 6.5. Garat rajonale të recituesve	Garat EUREKA 3 “Hasan Nahi” Nga 2000 nxënës garues te 25 komunave, nxënësit e shkollave tona morën 4 medalje te arta 2 te argjendta,3 te bronzta, ne mesin e 40 nxënësve me te përzgjedhur. Nxënëset e Gjimnazeve kanë marrë çmimin “Delegatet më të mira” - Shkolla e muzikës në garat ndërkombëtare Kroaci, Maqedoni, Lituan: vendi i parë i dytë dhe i tretë	Në bashkëpunim me
--	--	---	--------------------------

MASHT-in, Divizionin për Vlerësime dhe Standarde, DKA-ja, që nga muaj mars, merret me përgatitjet teknike dhe administrative të nxënësve, shkollave, administruesve dhe qendrave të testimit.

7. Përgatitja e testeve : Testi për klasat e V-ta Testi i Semimaturës Testi i Matura shtetërore	7.1. Përgatitja për realizimin e testit Kombëtar për 1342 nxënës, të 78 paraleleve e klasave të V-ta qe do t'i administrojnë 32 administrues të testit. 7.2. Përgatitja teknike dhe administrative për test të Semimaturës. Janë përcaktuar 7 qendra të testimit. Testit i nënshtrohen 1857 nxënës në 82 paralele. DKA përgatit, 193 administrues dhe 14 mbikëqyrës. 7.3. Jemi në fazën e përgatitjes edhe për Testin e Maturës Shtetërore. 7.3.1. Pilotimi i projektit “Matura Digjitale” (me nxënësit e kl. XI-ta të Gjimnazeve)
---	---

Shkenca nuk njeh kufij. Baza e zhvillimit të një populli është arsimit dhe shkenca. Më qellim të këmbimit dhe fitimit të këtyre vlerave, Drejtoria e Arsimit ne Gjilan ka lidhur **Marrëveshje Mirëkuptimi** me institucionet relevante profesionale të arsimit dhe me Drejtorinë e Arsimit të

Bursës për ngritje profesionale, trajnime e bashkëpunim në interes të IEA të komunës sonë. Përveç fitimit të përvojave në ngritje të cilësisë, këto marrëveshje kanë sjellë edhe të mira në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe mjeteve didaktike.

8. Marrëveshje Mirëkuptimi	8.1. Përgatitja e procedurave për bashkëpunimin e shkollave të Komunës së Gjilanit me shkollat e Komunës Osman Gazi nga Turqia. Shkollat e përfshira janë: SHFMU “Nazim Hikmet” SHFMU “Sadulla Brestovci”, SHFMU “Vatra e Diturisë” dhe SHML “Arbëria” dhe fillimi i procedurave për bashkëpunim i SHFMU “Thimi Mitko” me shkollën “Sulltan Murat” në Stamboll. 8.2. MEMO për realizimin e praktikës profesionale për 15 nxënësit e shkollës së teknikës në shkollën profesionale në Osman Gazi të Turqisë. 8.3. MEMO me USAID për Ndërtimin e I.P. në lagjen Dardania 8.4. MEMO me Institutin Pedagogjik trajnimi i mësimeve të shkollave profesionale për Arsimin e të rriturve. 8.5. MEMO me Bashkimin Evropian për TIK dhe mësimin elektronik në Arsim, faza II-të 8.6. MEMO me ALED për mekatronikë dhe operatorë prodhimi (mbi 120,000euro) dhe trajnimi i mësimeve të mekatronikës 8.7. MEMO me Oden ekonomike të Gjermanisë, pajisja me mjete për automekanik (20,000 – 30,000 euro) dhe trajnimi i mësimeve jashtë vendit
-----------------------------------	---

Në koordinim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrës për Financa në DKA, shfrytëzohet në mënyrë racionale e me kujdes buxheti për arsimim. Në tremujorin e parë të këtij viti ,nga fondi për arsim janë shpenzuar mjetet sipas përshkrimit në tabelë.

9.Shpenzimet tremujore për DKA dhe IEA	<table> <tr> <td>9.1.Paga</td><td>2.627.760.55 Euro</td></tr> <tr> <td>9.2 Shërbime dhe mallra</td><td>232.306.35 Euro</td></tr> <tr> <td>9.3.Komunali</td><td>40.000.00 Euro</td></tr> <tr> <td>9.4.Kapitale</td><td>69.520.35 Euro</td></tr> <tr> <td>Totali</td><td>2.969.587.25 Euro</td></tr> </table>	9.1.Paga	2.627.760.55 Euro	9.2 Shërbime dhe mallra	232.306.35 Euro	9.3.Komunali	40.000.00 Euro	9.4.Kapitale	69.520.35 Euro	Totali	2.969.587.25 Euro
9.1.Paga	2.627.760.55 Euro										
9.2 Shërbime dhe mallra	232.306.35 Euro										
9.3.Komunali	40.000.00 Euro										
9.4.Kapitale	69.520.35 Euro										
Totali	2.969.587.25 Euro										
10.Aktivitetet e ndërlidhura me financat	10.1. Realizimi i rrjedhjes së parasë në të gjitha IEA ,me propozimin e tyre; 10.2.Realizimi i rrjedhjes së parasë për nivele të cilat janë dërguar në MEF; 10.3.Realizimi i vizitës nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm; 10.4.Pergatitja e lëndëve për pagesa; 10.5Rregullimi i 185 faturave në sistemin E-financa në programin e komunës; 10.6 Menaxhimi i kontabilitetit për DKA-në dhe EIA-276 fatura.										

Megjithëqë investimet e deritashme në renovime e evitime defektesh në IEA, Drejtoria e Arsimit ka parashtruar kërkesa për investime më të mëdha në përmirësimin e disa prej këtyre institucioneve

11. Aktivitetet e ndërlidhura me Infrastrukturë	11.1. Pranimi kërkesave nga IEA-të për infrastrukturën shkollore si dhe realizimi i tyre 11.2. Mbikëqyrja e punëve në ndërtimin e sallave të edukatës fizike në SHMU “Abaz Ajeti “dhe “Liria “ 11.3. Rregullimin e kulmit në SHM” Arbëria” 11.4. Rregullimin e hyrjes në SHFMU” Selami Hallaqi” 11.5. Mbikëqyrja në punimet tjera në infrastrukturë 11.6. Evitimi i problemeve me gypat e kanalizimit në IP Ardhmëria 2, SHFMU” Selami Hallaqi” 11.7. Vendosja e kamerave në SHFMU “Selami Hallaqi “me financim të komunitetit ; 11.8. Aneksi i shkollës fillore ne fshatin Ponesh ne bashkëfinancim me komunën dhe USAID-in . Kete fillim muaji,qershori, do te fillojnë punimet e ndërtimit te çerdhes ne lagjen Dardania. Ne lagjen “ Arberia” do te ndërtohet çerdhe e re me donacion te organizatës” Patient Help Fond Kosova,organizate e Kuvajtit,me përfaqësim ne Prishtine. Per ditën e shkollës “ Bajram Curri “ me ,20 maj 2016 u përurua shkolla e re.
12. Projektet për investime kapitale përmes Bankës Gjermane për Zhvillim	12.1. SHMFU “Skënderbeu” ne fshatin Përlëpinë; 12.2. SHMFU “ Ibrahim Uruqi” ne fshatin Bresalc; 12.3. SHMFU “ Dëshmorët e Kombit “ në fshatin Livoq

SYNIMET

Zbatimi i reformave në arsim, për një sistem shkollor bashkëkohore, investimet në infrastrukturën shkollore: zgjerim hapësirave mësimore, salla të ed, fizike, fusha sportive, ngritjen profesionale të mësimeve, bashkëpunimi me MASHT-in, Qeverinë Komunale, Institucionet Universitare, Kolegjet, privatë, USAID-in, GIZ-in, Caritasin Zvicëran,Sew the Children- do të jenë objektivat dhe synimet e DKA-së dhe qeverisë komunale për një arsim cilësor për nxënës të komunës së Gjilanit.

INVESTIME INVENTARI

SHFMU “ Avdullah Tahiri “	100 karrige	50 banka
SHFMU ‘Musa Zajmi”	100 karrige	50 banka
Gjimnazi”,Zenel Hajdini”	100 karrige	50 banka

...

KONFERENCË PËR MEDIJA:

GJILAN,05.05.2016,ORA 11:00

REZULTATET E PUNËS NË TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2016 NË DKA

Të nderuar përfaqësues të mediave, mirë se erdhët në konferencën për shtyp ,me qellim të informimit të opinionit për sukseset edhe rezultatet e punës tre mujore të këtij viti të Drejtorisë së Arsimit,

Ju njoftoj se:

Në fund të dhjetorit 2015 është bërë analiza e suksesit dhe rezultateve të arritura në procesin mësimor për gjysmë vjetorin e parë të vitit mësimor 2015/2016. Në përfundim të gjysmë vjetorit të parë mësimor, analiza e suksesit në të gjitha shkollat ka rezultuar me ngritje të cilësisë në arsimin gjilanas. Krahasuar me gjysmë vjetorin e vitit paraprak, ky gjysmë vjetor shënon një ngritje për 0,40% më të lartë në gjithë përfshirjen e 18,160 nxënësve në arsim të të gjitha niveleve .

Zhvillimi normal i procesit mësimor dhe ngritja e cilësisë në arsim në të gjitha IEA , duke përfshirë edhe Fëmijët me Nevoja të Veçanta (FNV) , është objektivi kryesor i Drejtorisë së Arsimit në Gjiilan.

Po si do të realizohet ky objektivi dhe si do të maten rezultatet, ndoshta do të pyesni ju dhe interesimi i opinionit, sidomos prindërit ?

-Po, lehtë! Me vullnet, dashuri dhe profesionalizëm.

Tanimë të gjithë mësimdhënësit që punojnë në arsim kanë kualifikimet bazë që kërkohen për punë në arsim dhe janë të licencuar. Me gjithë përgatitjet e tyre adekuate për mësimdhënie, në bashkëpunim me MASHT-in, GIZIN, Institutin Pedagogjik, BEP-in, Caritasin Italian, Sew the Children, kanë vazhduar e po vazhdojnë trajnimet e ndryshme në ngritjet profesionale në mësimin e metodave të reja më bashkëkohore të mësimdhënies:

Trajnimet për:

Vlerësim Formativ e sumativ

Vlerësimin kritik për lexim dhe shkrim,

Mësimdhënia dhe të nxënit në shkencat natyrore për klasat fillore 1-5,

Trajnimi i mësimdhënësve të shkollave pilot në zbatimin e fushave kurikulare.

Rezultatet:

Fitoret e njëpasnjëshme të nxënësve në garat komunale, republikane, regjionale e ndërkombëtare në fushat e kulturës, arti, shkencës dhe sportit: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze,

Matematikë, Kimi, Muzikë, Art pamor, Sporti shkollor dhe sukseesi i ngritur, ani se me një përqindje të vogël

Indikatorët:

Analiza e suksesit, testet e nxënësve, garat në nivel shkolle për lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Kimi, Fizikë ,Biologji, testet e semimaturës, testi kombëtar, testi PISA 2015, Testi i klasave të pesta që, për herë të parë është mbajtur pas çlirimit, më 20 prill 2016,Olimpiada e Matematikanëve në nivel shkolle dhe komune për nxënës të klasave 9.10.11,12.Medaljet e nxënësve në garat EUREKA 3,organizuar nga Gjimnazi “ Hasan Nahi” në Prishtine etj

Natyrisht, të gjitha punët në Drejtorinë e Arsimit kryhen në bazë të **Planit Vjetor të punës së DKA-së, Vlerësimit të Planeve Zhvillimore të Shkollave, dhe Planit të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve në nivelin e Edukimit Parashkollor.**

Tani në nivel të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë, po behën përgatitjet për përfundimin e vitit shkollor për klasat e 12-ta . Përveç mbrëmjeve te maturës, preokupim i shkollave dhe DKA-së janë përgatitjet teknike e administrative për testin e arritshmerisë te klasave te 9-ta dhe testin kombëtar për kl 12-ta

Më 17 maj 2016, DKA-ja në Gjilan është nikoqire e organizimit të Festës së Abetares në nivel të Republikës së Kosovës, ku do të marrin pjesë 7 regjione të R. Kosovës, nga Shqipëria dhe Presheva.

Në koordinim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, dhe Zyrës se Financave në DKA në mënyrë racionale e të drejtë është shfrytëzuar buxheti për arsim. Në tremujorin e parë të këtij viti, nga fondi për arsim janë shpenzuar mjetet për:

1. Paga.....2.627.760.55 euro
2. Shërbime dhe mallra.....232.306.35 euro
3. Shërbime komunale.....40.000.00euro
4. Shpenzime kapitale.....69.520.35 euro.

INFRASTRUKTURA

Këto ditë do të përurojmë shkollën e re “ Bajram Curri “në Shurdhan,

* Po ndërtohen sallat e ed, fizike për shkollën “ Liria “në Pogradjë, dhe për shkollën fillore “ Abaz Ajeti”

* Është në tenderim projekti për ndërtimin e çerdhes në lagjen “Dardania”

* Me mbarimin e vitit mësimor, do të fillojnë punimet për ndërtimin e kampusit të shkollave të mesme.

* Kryetari i Komunës z. Lutfi Haziri ka aprovuar pranimin e donacionit të organizatës PATIENT “HELP FOND KOSOVA” për financim të ndërtimit të një çerdheje në “ Abaz Ajeti”

* Po fillon ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Ponesh, me donacion të USAID-it dhe me participim të komunës.

* Vazhdojnë punimet për ndërtimin e shkollës së Artit Pamor.

* Do të nisë së shpejti ndërtimi i çerdhes në lagjen Dardania

Kem përcaktuar prioritetet për investime kapitale përmes BANKËS GJERMANE PËR ZHVILLIM për renovimin e shkollave: SHMFU “ Skënderbeu “ në Përlëpnicë, SHFMU” Ibrahim Uruqi” në Bresalc, SHFMU” Dëshmoret e Kombit” në fshatin Livoq i Ulët.

Bashkëpunimi:

Drejtoria Komunale e Arsimit ka një bashkëpunim të mirë me MASHT-in, Fakultetin e Edukimit, Kolegjet private, USAID-in, GIZ-in, Caritasin Zvicëran, Sew the Children, Drejtorinë e Arsimit të Bursës, Institutin Pedagogjik, OJQ-të me interes arsimor, Shërbimin Policor etj. BE-ne(Zyrën e Bashkimit Evropian në Prishtinë për financim në infrastrukturën shkollore)

Të gjitha rezultatet e sukseset në arsimin gjilanas janë të lidhura ngushtë me përkrahjen e plotë të kryetarit të komunës z. Lutfi Hazirit i cili mbështet pa rezerve punën e Drejtorisë së Arsimit ,të cilit i shprehi falënderim.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit,

Nazmi Musa